

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORATI I ADMINISTRATIVËS - ZHANTARIA E ADMINISTRATIVËS	
Nr.faq/Blash:	1729	
Data/Orë:	27 08 2026	
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 27.08.2026

Komuna e Fushë Kosovës, bazuar në nenin 68, paragrafi 3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 17, paragrafi 1, nën - paragrafi 1.2, nenin 19, nenin 21, nenin 22, paragrafi 1, nën - paragrafi 1.2, nenin 28, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, nenin 17, paragrafi 17.1, shkronja (ç, ë) të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 98, të datës 17.08.2012, vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 263, të datës 27.08.2026 shpallë këtë:

NJOFTIM

Për konsultim publik lidhur me ndryshim-plotësimin e Rregullores Nr. 145/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale

Njoftimi për konsultim publik lidhur me 'Ndryshim-plotësimin e Rregullores Nr. 145/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale', është i hapur nga data: **27.08.2026 deri më datën 10.09.2026.**

'Ndryshim-plotësimi i Rregullores Nr. 145/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimi / Klasifikimi i vendeve të punës në Administratën Komunale', është i publikuar në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Fushë-Kosovës.

Komentet, sugjerimet apo vërejtjet lidhur me ndryshim-plotësimin e projekt-aktit normativ, nga qytetarët dhe Shërbyesit Civil të Komunës, mund të adresohen në takimin publik, në Drejtorinë e Administratës dhe Zyrën e Personelit në katin e dytë.

Komuna e Fushë-Kosovës e ka paraparë edhe mbajtjen e një takimi të Konsultimit Publik, i cili do të mbahet me datën: **08.09.2026, me fillim prej orës 14:00h** në Sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Bartës të takimit publik janë Drejtorët e Komunës dhe Grupi Punues.

Me respekt,





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Në zbatim të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenit 58, shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenit 43, shkronja (ë), neni 48, paragrafi 48.2 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën _____ miraton:

Projekt -Rregullore për Ndryshim-Plotësimin e Rregullores Nr.145, të datës 03.12.2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale.

Neni 1

1. Neni 8 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim :
Drejtoria për Kulturë.
2. Neni 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.7, fshihet pika 1.7.2 i Rregullores bazë.
3. Neni 8 paragrafi 1 i Rregullores bazë, fshihet nën-paragrafi 1.10 me pikat 1.10.1 dhe 1.10.2 .
4. Neni 8 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11 i Rregullores bazë ndryshohet emërtimi i Drejtorisë dhe riformulohet si në vijim:
Drejtoria për Urbanizëm, Mjedis dhe Pronë.
5. Neni 8 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11, pika 1.11.1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:
Sektori për Urbanizëm dhe Mjedis;
6. Neni 8 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11, fshihet pika 1.11.2.
7. Neni 8 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11, shtohet pika si në vijim:
1.11.3. Sektori për Trajtimin e ndërtimeve pa leje;
8. Neni 8 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11, shtohet pika si në vijim:
1.11.4. Sektori i Pronës.
9. Neni 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.14, fshihet pika 1.14.1.
10. Neni 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.14 pika 1.14.3 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:
Sektori për Inspektime të Shërbimeve Publike, Mjedisit dhe Hapësirave Publike.

11. Neni 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.14, plotësohet me pikën si në vijim:
1.14.4 Sektori për Inspektime të Komunikacionit.

12. Neni 8 paragrafi 1, i Rregullores bazë plotësohet si në vijim:
1.24 Drejtoria për Rini dhe Sport:
1.24.1. Sektori për Rini;
1.24.2. Sektori për Sport;

1.25 Drejtoria e Parqeve:
1.25.1 Sektori për Planifikimin e Parqeve;
1.25.2 Sektori për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Parqeve

Neni 2

Neni 9, paragrafi 5 i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:
Numri i të punësuarve në Drejtorinë e Administratës dhe Shërbimeve të Përbashkëta është pesëdhjetë e një (51).

Neni 3

1. Neni 10, paragrafi 3 i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:
Numri i të punësuarve në Sektorin për Shërbime të Përbashkëta është njëzet e tre (23).

Neni 4

Neni 11, paragrafi 3 i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:
Numri i të punësuarve në Sektorin për Gjendje Civile është nëntë (9).

Neni 5

Neni 21, paragrafi 5 i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:
Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Arsim është gjashtëmbëdhjetë (16).

Neni 6

Neni 25, paragrafi 3 i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:
Numri i të punësuarve në Sektorin për Shërbime Administrative për Arsim është gjashtë (6).

Neni 7

Neni 35 i Rregullores bazë fshihet.

Neni 8 Drejtoria për Kulturë

1. Misioni i Drejtorisë për Kulturë, është të përmirësojë dhe pasurojë jetën e komunitetit duke promovuar kulturën lokale dhe trashëgimin kulturore, duke u angazhuar dhe duke u mbështetur në aktivitetet kulturore, me synim që të bashkojë njerëzit përmes ngjarjeve kulturore, të fuqizojë aktivitetet kulturore përmes programeve kulturore.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Kulturë janë:
 - 2.1 Zhvillimi i politikave dhe strategjive për promovimin e kulturës dhe trashëgimisë Kulturore;
Zhvillimi dhe zbatimi i programeve, ngjarjeve dhe iniciativave kulturore për promovimin e arteve, trashëgimisë dhe traditave lokale si dhe mbështetja e artistëve, artizanëve dhe organizatave kulturore lokale;
 - 1.1. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore, muzeve, galerive dhe vendeve historike;
 - 1.2. Planifikimi dhe organizimi i ngjarjeve kulturore dhe lehtësimi i përfshirjes së komunitetit në aktivitete kulturore si dhe komunikimi i informacionit për ngjarjet për publikun;
 - 1.3. Administrimi i garantëve dhe fondeve për të mbështetur iniciativat kulturore dhe vlerësimi dhe përzgjedhja e projekteve që përputhen me qëllimet e komunës në fushën e kulturës;
 - 1.4. Hartimi i politikave dhe strategjive për zhvillimin afatgjatë të bibliotekës dhe arkivit të qytetit, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me nevojat e komunitetit dhe standardet e përcaktuara;
 - 1.5. Bashkëpunim me organizata kulturore lokale dhe kombëtare, institucionet arsimore, shoqatat kulturore, si dhe organizimi i festivaleve kulturore, ekspozitave dhe koncerteve;
 - 1.6. Sigurimi që programet kulturore të jenë të qasshme dhe mikpritëse për të gjithë anëtarët e komunitetit, pavarësisht nga prejardhja e tyre.
3. Drejtoria për Kulturë udhëhiqet nga Drejtori dhe i raporton Kryetarit të Komunës.
4. Në kuadër të kësaj Drejtorie bëjnë pjesë:
 - 4.1. Sektori për Kulturë dhe Trashëgimi Kulturore;
 - 4.2. Sektori për Bibliotekë dhe Arkiv të Qytetit.
5. Numri i të punësuarve në Drejtorinë e Kulturës është njëmbëdhjetë (11).

Neni 9

Neni 37 i Rregullores bazë fshihet.

Neni 10

Neni 40, paragrafi 5 i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:
Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi është njëmbëdhjetë (11).

Neni 11

Neni 42, paragrafi 3 i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:
Numri i të punësuarve në Sektorin për Gjeodezi është katër (4).

Neni 12

Neni 43 i Rregullores Bazë fshihet.

Neni 13

Neni 44 i Rregullores bazë fshihet.

Neni 14

Neni 45 i Rregullores bazë fshihet.

Neni 15

Neni 46 i Rregullores bazë fshihet.

Neni 16

Neni 47 i Rregullores bazë fshihet.

Neni 17

Neni 48 i Rregullores bazë fshihet.

Neni 18

Drejtoria për Urbanizëm, Mjedis dhe Pronë

1. Misioni i Drejtorisë për Urbanizëm, Mjedis dhe Pronë është udhëheqja, menaxhimi i planifikimit dhe zhvillimit hapësinor në mënyrë të qëndrueshme dhe të kontrolluar, përfshirë mbrojtjen e mjedisit dhe eficientën energjetike, përgatitjen e planeve të detajuara urbane, miratimin e projekteve të ndërtimit, administrimi efikas dhe transparent të pronës komunale, garantimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të pronës dhe mbrojtjen e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Komunës.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Urbanizëm ,Mjedis dhe Pronë janë:
 - 2.1 Zhvillimi i planeve dhe rregulloreve urbane dhe mjedisore të detajuara, përfshirë përcaktimin e zonave të ndërtimit, infrastrukturës, dhe zonave të gjelbra si dhe sigurimi që këto plane janë në përputhje me standardet mjedisore dhe urbane;
 - 2.2 Menaxhimi efikas dhe transparent i proceseve të lejeve të ndërtimit dhe lejeve mjedisore komunale, përfshirë lëshimin e tyre si dhe mbikëqyrja e zbatimit të planeve të ndërtimit në përputhje me lejet e dhëna;
 - 2.3 Menaxhimi efikas dhe transparent i pronës komunale, duke siguruar shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e saj në përputhje me planet dhe nevojat e komunës;
 - 2.4 Mbajtja e të dhënave të sakta dhe të azhuruara për tokën dhe objektet në pronësi të komunës duke siguruar integritetin dhe qasjen e lehtë në të dhëna
 - 2.5 Ruajtja e parqeve, zonave të mbrojtura dhe burimeve të natyrës përmes planeve hapësinore komunale;
 - 2.6 Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor për publikun dhe promovim i praktikave të qëndrueshme mjedisore, si dhe organizimi i konsultimeve dhe dëgjimeve publike në lidhje me ndryshimet e planeve në zonat urbane dhe rurale;
 - 2.7 Mbikëqyrja e zhvillimit urban dhe mjedisor dhe raportimi i progresit dhe sfidave në zbatim të planeve dhe politikave të urbanizmit;
 - 2.8 Planifikimi dhe zbatimi i masave për menaxhimin e rrezikut mjedisor dhe natyror, veçanërisht në rastet e emergjencave mjedisore ose fatkeqësive natyrore;
 - 2.9 Nxjerrja e vendimeve për regjistrimin e të drejtës së pronësisë në emër të Komunës për paluajtshmëritë e mbetura pa pronar, duke siguruar legalitetin dhe mbrojtjen e pronës komunale;
 - 2.10 Zhvillimi i procedurave administrative për trajtimin e uzurpimeve arbitrare të tokës në pronësi të komunës, duke nxjerrë vendimet për lirin e pronës komunale të uzurpuar;
 - 2.11 Identifikimin, klasifikimin dhe vlerësimin i pronave të paluajtshme në pronësi të komunës duke siguruar të dhëna të sakta për menaxhimin e tyre;
 - 2.12 Shqyrtimi dhe vendosja për kërkesat e personave fizikë dhe juridikë në procedurë administrative për rregullimin e marrëdhënieve pronësore-juridike, lidhur me pronën komunale
 - 2.13 Planifikimi për infrastrukturën thelbësore si rrugët, shërbimet komunale, parqet dhe objekte publike për të akomoduar nevojat e popullsisë dhe të bizneseve në rritje;

- 2.14 Shqyrtimi dhe hartimi i planeve të hapësinore lokale për të siguruar që ato janë në përputhje me legjislacionin, udhëzimet administrative, rregulloret dhe standardet e planifikimit urban;
- 2.15 Sigurimi që të gjitha aktivitetet e ndërtimit janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret janë të sigurta, të qëndrueshme dhe respektojnë standardet e vendosura;
- 2.16 Siguron trajtimin e ndërtimeve pa leje sipas Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë;
- 2.17 Ofrimi i përgjigjeve dhe këshillimeve të nevojshme për ndërtuesit, arkitektët dhe të tjerët që janë të përfshirë në procesin e ndërtimit ;
- 2.18 Largon pengesat për promovimin e efikasitetit të energjisë;
- 2.19 Vë në funksion teknologjinë me efikasitet të lartë të energjisë, sistemet moderne të matjes dhe kontrollit dhe sistemet e menaxhimit të energjisë;
- 2.20 Zbaton metoda moderne të menaxhimit të energjisë dhe promovon përdorimin e pajisjeve dhe makinerive efikase, si dhe të burimeve të rinovueshme të energjisë;
- 2.21 Këshillon dhe rekomandon konsumatorët e energjisë për rëndësinë dhe përfitimet e zbatimit të masave për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe promovon kërkimin bazë dhe të aplikuar në fushën e efikasitetit të energjisë,
- 2.22 Menaxhimi dhe përditësimi i sistemit të adresave në komunë, duke krijuar dhe mirëmbajtur adresat në përputhje me zhvillimet urbanistike , siguruar qasshmërinë e saktë të tyre për qytetarët dhe institucionet.

3. Drejtoria për Urbanizëm, Mjedis dhe Pronë udhëhiqet nga Drejtori i Drejtorisë i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Në kuadër të kësaj Drejtorie bëjnë pjesë:

- 4.1 Sektori për Planifikim Urban dhe Mjedis;
- 4.2 Sektori për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje;
- 4.3 Sektori për Pronë;

5. Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Urbanizëm, Mjedis dhe Pronë është gjashtëmbëdhjetë (16).

Neni 19

Sektori për Urbanizëm dhe Mjedis

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Planifikim Urban janë:

- 1.1 Zhvillimi i planeve dhe rregulloreve hapësinore komunale të detajuara, përfshirë përcaktimin e zonave të ndërtimit dhe infrastrukturës si dhe sigurimin që këto plane dhe rregullore janë në përputhje me ligjet dhe standardet urbane;
- 1.2 Menaxhimi efikas dhe transparent i proceseve të lejeve ndërtimore dhe lejeve mjedisore Komunale, përfshirë lëshimin e tyre, monitorimin e zbatimit të planeve të ndërtimit dhe masave mjedisore në përputhje me ligjet në fuqi;
- 1.3 Zhvillimi i rregulloreve mjedisore të detajuara, përfshirë përcaktimin e zonave të gjelbra dhe sigurimi që këto rregullore janë në përputhje me standardet mjedisore;
- 1.4 Ruajtja e parqeve, zonave të mbrojtura dhe burimeve të natyrës përmes planeve hapësinore

komunale;

- 1.5 Planifikimi i infrastrukturës së rrugëve, shërbimeve komunale, parqet dhe objektet publike për të akomoduar nevojat e popullsisë dhe bizneseve në rritje;
 - 1.6 Analizimi dhe vlerësimi i projekteve dhe planeve zhvillimore për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe planet e urbanizmit;
 - 1.7 Shqyrtimi i planeve të zhvillimit urban për të siguruar përputhshmërinë me strategjitë shtetërore të planifikimit të qytetit, fshatrave dhe komunitetit;
 - 1.7 Propozimi i masave për përmirësimin e infrastrukturës urbane, rurale si dhe modernizimin e zonave të zhvilluara, duke përfshirë përmirësimin e rrugëve, parqeve dhe shërbimeve publike;
 - 1.8 Krijimi i strategjive afatgjata për zhvillimin hapësinorë lokale, duke përfshirë parashikimin e nevojave të ardhshme të infrastrukturës dhe zhvillimin e zonave të reja urbane;
 - 1.9 Vlerësimi dhe rishikimi periodik i planeve hapësinore lokale për të siguruar që ato mbeten të përshtatshme me ndryshimet demografike dhe nevojat ekonomike të komunitetit;
 - 1.11 Planifikimi dhe zbatimi i masave për menaxhimin e rrezikut mjedisor dhe natyror, veçanërisht në rastet e emergjencave mjedisore ose fatkeqësive natyrore;
 - 1.12 Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor për publikun dhe promovim i praktikave të qëndrueshme mjedisore;
 - 1.13 Monitorimi dhe raportimi i ndikimit të projekteve të ndërtimit dhe zhvillimit në mjedis, duke propozuar masa korrigjuese kur është e nevojshme;
 - 1.14 Bashkëpunimi me Drejtoritë e tjerë komunale dhe palët e interesuara për të integruar nevojat e komunitetit në planet urbane dhe për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm;
 - 1.15 Ofrimi i përgjigjeve dhe këshillimeve të nevojshme për ndërtuesit, arkitektët dhe të tjerët që janë të përfshirë në procesin e ndërtimit për të siguruar që të gjitha aktivitetet janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret mjedisore ;dhe
 - 1.16 Koordinimi me organizatat mjedisore dhe institucionet qeveritare për zbatimin e projekteve të përbashkëta që synojnë përmirësimin e mjedisit dhe mbrojtjen e burimeve natyrore.
 - 1.17 Largon pengesat për promovimin e efikasitetit të energjisë;
 - 1.18 Vë në funksion teknologjinë me efikasitet të lartë të energjisë, sistemet moderne të matjes dhe kontrollit dhe sistemet e menaxhimit të energjisë;
 - 1.19 Zbaton metoda moderne të menaxhimit të energjisë dhe promovon përdorimin e pajisjeve dhe makinerive efikase, si dhe të burimeve të rinovueshme të energjisë;
 - 1.20 Këshillon dhe rekomandon konsumatorët e energjisë për rëndësinë dhe përfitimet e zbatimit të masave për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe promovon kërkimin bazë dhe të aplikuar në fushën e efikasitetit të energjisë,
2. Sektori për Planifikim Urban dhe Mjedis udhëhiqet nga Udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtoritë Drejtorisë për Urbanizëm, Mjedis dhe Pronë.
 3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Planifikim Urban dhe Mjedis është gjashtë (6).

Neni 20

Sektori për Trajtimin e ndërtimeve pa leje

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje janë:
 - 1.1 Organizimi dhe trajnimi i grupeve profesionale dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore për procedurën e legalizimit;
 - 1.2 Organizimi i çështjeve profesionale për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave (dokumentacioneve) për legalizim;
 - 1.3 Organizimi i çështjeve profesionale për vlerësimin e objekteve pa leje;
 - 1.4 Regjistrimin e të gjitha ndërtimeve pa leje të kategorive I dhe II brenda territorit të Komunës dhe përfshirjen e të dhënave në Bazën e të Dhënave të Legalizimit dhe përdorimin e tij në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - 1.5 Trajtimin e ndërtimeve të kategorive I dhe II në pajtim me ligje dhe aktet nënligjore përkatëse në fuqi;
 - 1.6 Trajtimin e ankesave të parashtruara gjatë procesit të trajtimit të ndërtimeve pa leje sipas legjislacionit dhe akteve tjera nënligjore;
 - 1.7 Konstatimi dhe delegimi i informatave për objektet e ndërtuara në mospërputhje me ligjet ndërtimore, standardet, dokumentacionet urbanistike në fuqi, si dhe me rregulloret dhe Manualin për Legalizim;
 - 1.8 Kontrollon dokumentacionin teknik në harmoni me ligjet ndërtimore, standardet dhe dokumentacionet urbanistike në fuqi, si dhe me rregulloren dhe manualin për legalizim;
 - 1.9 Koordinimi i të gjitha punëve procedurale nga lëmi i ndërtimeve pa leje;
 - 1.10 Identifikimin dhe përfshirjen në listën e pritjes të të gjitha ndërtimeve pa leje brenda territorit të Komunës të cilat ndodhen në pronë publike, në pronë shoqërore, në toka bujqësore, sipërfaqe të mbrojtura, zona të mbrojtura, zonat të veçanta të mbrojtura, zona të veçanta dhe korridore infrastrukture;
 - 1.11 Përfshirjen e ndërtimeve të legalizuara në dokumentet e ardhshme të planifikimit hapësinor lokal; dhe
 - 1.12 Informimi dhe orientimi i palëve dhe qytetarët për procedurat e legalizimit të ndërtimeve pa leje .
2. Sektori për Trajtimin e ndërtimeve pa leje udhëhiqet nga Udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtoritë Drejtorisë për Urbanizem, Mjedis dhe Pronë.
3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Trajtimin e ndërtimeve pa leje është katër (4).

Neni 21

Sektori për Pronë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Pronë janë:

- 1.1 Menaxhimi efikas dhe transparent i pronës komunale, duke siguruar shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e saj në përputhje me planet dhe nevojat e komunës;
- 1.2 Mbajtja e të dhënave të sakta dhe të azhurnuara për tokën dhe objektet në pronësi të komunës, duke siguruar integritetin dhe qasjen e lehtë në të dhëna;
- 1.3 Nxjerrja e vendimeve për regjistrimin e të drejtës së pronësisë në emër të Komunës për paluajtshmëritë e mbetura pa pronar, duke siguruar legalitetin dhe mbrojtjen e pronës komunale;
- 1.4 Zhvillimi dhe zbatimi i procedurave të shpronësimit dhe këmbimit për ngastrat e planifikuara për interes publik, sipas planeve hapësinore të komunës;
- 1.5 Përgatitja e vendimeve të shpronësimit dhe këmbimit për personat fizikë dhe juridikë, duke siguruar që procesi të jetë i drejtë dhe transparent;
- 1.6 Sigurimi i marrëveshjeve dhe kontratave për sigurimin e tokës së nevojshme për realizimin e projekteve të interesit publik, duke mbrojtur interesat e komunës dhe të qytetarëve;
- 1.7 Evidentimi dhe vlerësimi i tokës së planifikuar për shpronësim, duke siguruar që të gjitha ngastrat janë të përfshira dhe të identifikuar si duhet;
- 1.8 Zhvillimi i procedurave administrative për trajtimin e uzurpimeve të tokës në pronësi të komunës, duke nxjerrë vendimet për lirimin e pronës komunale të uzurpuar;
- 1.9 Identifikimin, klasifikimin dhe vlerësimin e pronave të paluajtshme në pronësi të komunës, duke siguruar të dhëna të sakta për menaxhimin e tyre;
- 1.10 Shqyrtimi dhe vendosja për kërkesat e personave fizikë dhe juridikë në procedurë administrative për rregullimin e marrëdhënieve pronësore-juridike, lidhur me pronën komunale;

2. Sektori për Pronë udhëhiqet nga Udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Planifikim Urban, Mjedis dhe Pronë.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Pronë është pesë (5).

Neni 22

1. Neni 49, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2. i Rregullores bazë fshihet.
2. Neni 49 paragrafi 5 i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:
Numri i të punësuarve në Drejtorinë e Shërbimeve Publike është njëzetënjë (21).

Neni 23

Neni 50 paragrafi 3 i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:

Numri i të punësuarve në Sektorin për Shërbime Publike është shtatëmbëdhjetë (17).

Neni 24

Neni 52 paragrafi 5 i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:

Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave është njëmbëdhjetë (11).

Neni 25

Neni 53 paragrafi 3 i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:

Numri i të punësuarve në Sektorin për Investime Kapitale është katër (4)..

Neni 26

Neni 54 paragrafi 3 i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:

Numri i të punësuarve në Sektorin për Menaxhimin e Kontratave është gjashtë (6).

Neni 27

1. Neni 55, paragrafi 2, i Rregullores bazë, fshihet pika 2.3.
2. Neni 55, paragrafi 2, i Rregullores bazë, fshihet pika 2.6.
3. Neni 55, paragrafi 2, i Rregullores bazë, plotësohet me nënparagrafët si në vijim:
 - 2.11. Mbikëqyrja inspektuese e shërbimeve publike komunale dhe kontrollimi i respektimit të kushteve dhe standardeve të përcaktuara me legjislacionin dhe aktet komunale në fushën e shërbimeve publike;
 - 2.12. Mbikëqyrja inspektuese e shfrytëzimit dhe mbrojtjes së hapësirave publike, përfshirë trotualet, sheshet, sipërfaqet publike, gjelbërimin dhe hapësirat e tjera në administrim apo menaxhim të komunës, në pajtim me legjislacionin dhe aktet komunale;
 - 2.13. Ushtrimi i mbikëqyrjes inspektuese në fushën e komunikacionit rrugor, në kuadër të kompetencave të komunës, përfshirë kontrollin e respektimit të dispozitave ligjore dhe komunale që kanë të bëjnë me transportin rrugor lokal, transportin urban dhe urbano-periferik, auto-taksi, stacionet dhe vendndalimet, si dhe çështjet e tjera të komunikacionit dhe transportit që me ligj janë në kompetencë të komunës;
 - 2.14. Mbikëqyrja e respektimit të kushteve të përcaktuara nga organet komunale për shfrytëzimin e rrugëve lokale, hapësirave rrugore, trotuareve, parkingjeve publike dhe infrastrukturës tjetër të komunikacionit që është nën kompetencën e komunës;

- 2.15. Inspektimi dhe ndërmarrja e masave ndaj shfrytëzimit të kundërligjshëm të hapësirave publike, pengesave dhe ndërhyrjeve të paautorizuara në hapësirat publike dhe infrastrukturën komunale, sipas kompetencave të përcaktuara me ligj dhe akte komunale;
- 2.16. Pranimi, shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave, kërkesave dhe informatave të qytetarëve, personave fizikë dhe juridikë që kanë të bëjnë me çështjet nga kompetenca e Drejtorisë;
3. Neni 55, paragrafi 4, nënparagrafi 4.3 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:
4.3. Sektori për Inspektime të Shërbimeve Publike, Mjedisit dhe Hapësirave Publike;
4. Neni 55, paragrafi 4, plotësohet me nënparagrafin, si në vijim:
4.4. Sektori për Inspektime të Komunikacionit;
5. Neni 55, paragrafi 5 i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:
Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Inspektime është njëzetete pesë (25).

Neni 28

Fshihet neni 56 i Rregullores bazë.

Neni 29

1. Neni 57, paragrafi 1, i Rregullores bazë, plotësohet me nënparagrafin si në vijim:
1.9. Ndërmarrja dhe procedimi i veprimeve për ekzekutimin e masave inspektuese, përfshirë rastet për të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, kërkohet largimi, rrënimi apo kthimi i gjendjes në përputhje me kërkesat ligjore;
2. Neni 57, paragrafi 3, i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:
Numri i të punësuarve në Sektorin për Inspektime të Ndërtimit është dhjetë (10).

Neni 30

1. Neni 58, i Rregullores bazë ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:
Sektori për Inspektime të Shërbimeve Publike, Mjedisit dhe Hapësirave Publike;
2. Neni 58, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, i Rregullores bazë ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:
Inspektimi dhe ndërmarrja e masave ndaj hedhjes, grumbullimit apo deponimit të kundërligjshëm të mbeturinave dhe veprimeve të tjera që cenojnë pastërtinë dhe mjedisin, brenda kompetencave të komunës;
3. Neni 58, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, i Rregullores bazë ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

Inspektimi dhe ndërmarrja e masave ndaj shfrytëzimit, zënies apo uzurpimit të kundërligjshëm të hapësirave publike, përfshirë trotualet, sheshet, sipërfaqet e gjelbra dhe hapësirat e tjera publike që janë nën administrimin ose kompetencën e komunës;

4. Neni 58, paragrafi 1 i Rregullores bazë, plotësohet me nënparagrafët si në vijim:

1.9. Inspektimi, në pajtim me aktet komunale dhe legjislacionin në fuqi, i vendosjes së objekteve të përkohshme, kiosqeve, tendave, terasave, reklamave, tabelave, pajisjeve, pengesave dhe elementeve të tjera në hapësirat publike, kur mbikëqyrja e tyre është në kompetencë të komunës;

1.10. Kryerja e inspektimeve sipas detyrës zyrtare, sipas planit të inspektimeve dhe në bazë të informatave apo ankesave, si dhe reagimi në rastet që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme inspektuese, brenda kompetencave të Sektorit;

1.11. Ndërmarrja e masave inspektuese dhe administrative për eliminimin e shkeljeve të konstatuara, përfshirë urdhërimin e largimit të pengesave, lirimin e hapësirës publike, kthimin e gjendjes në përputhje me kërkesat ligjore, si dhe masat e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;

5. Neni 58, paragrafi 3, i Rregullores bazë ndryshohet si në vijim:

Numri i të punësuarve në Sektorin për Inspektime të Shërbimeve Publike, Mjedisit dhe Hapësirave Publike është nëntë (9).

Neni 31

Sektori për Inspektime të Komunikacionit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Inspektime të Komunikacionit janë:

1.1 Ushtrimi i mbikëqyrjes inspektuese në fushën e komunikacionit dhe transportit rrugor, brenda kompetencave të përcaktuara për nivelin komunal, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe aktet komunale;

1.2 Kontrollimi dhe inspektimi i transportit të rregullt urban dhe ndërurban të udhëtarëve, përfshirë respektimin e linjave, itinerareve, orareve, vendndalimeve dhe kushteve të tjera të përcaktuara nga organet kompetente komunale;

1.3 Kontrollimi dhe inspektimi i transportit auto-taksi, në kuadër të kompetencave komunale, përfshirë verifikimin e lejeve, dokumentacionit dhe respektimin e kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe aktet komunale;

1.4 Mbikëqyrja e respektimit të kushteve të përcaktuara për shfrytëzimin e stacioneve të autobusëve, vendndalimeve dhe hapësirave të tjera të destinuara për transportin publik, në kuadër të kompetencave të komunës;

1.5 Mbikëqyrja inspektuese e shfrytëzimit të rrugëve lokale, trotuareve, parkingjeve publike dhe infrastrukturës tjetër të komunikacionit që është në administrim ose kompetencë të komunës, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve komunale;

1.6 Kontrollimi i respektimit të kushteve dhe pëlqimeve të lëshuara nga organet kompetente komunale për shfrytëzimin e rrugëve dhe hapësirave rrugore, përfshirë rastet e ndërhyrjeve, pengesave apo shfrytëzimeve të paautorizuara, kur mbikëqyrja e tyre është në kompetencë të komunës;

1.7 Mbikëqyrja e respektimit të dispozitave komunale lidhur me parkingjet publike, vendparkimet dhe hapësirat e rezervuara, në masën e përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe aktet komunale;

1.8 Pranimi dhe trajtimi i ankesave, kërkesave dhe informatave nga qytetarët dhe personat juridikë lidhur me çështjet e komunikacionit dhe transportit që janë në kompetencë të Sektorit;

1.9 Ndërmarrja e masave inspektuese dhe administrative, nxjerrja e urdhrave dhe vendimeve, shqiptimi i gjobave dhe inicimi i procedurave të tjera përkatëse, vetëm në rastet dhe në masën e autorizuar me legjislacionin në fuqi;

1.10 Bashkëpunimi dhe koordinimi me Policinë e Kosovës, drejtoritë përkatëse komunale, organet e administratës shtetërore dhe institucionet e tjera kompetente për çështjet që lidhen me komunikacionin dhe transportin;

1.11 Mbajtja e evidencave të inspektimeve, procesverbaleve, vendimeve, gjobave dhe masave të tjera të ndërmarra, si dhe përgatitja e raporteve periodike për aktivitetet e Sektorit.

2. Sektori për Inspektime të Komunikacionit udhëhiqet nga Udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Inspektime.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Inspektime të Komunikacionit është pesë (5).

Neni 32

1. Neni 62 paragrafi 2, nën-paragrafi 2.1 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:
Sipas kërkesave të Drejtorive të Komunës, harton përgatitjen e planit vjetor të prokurimit në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe prioritetet e Komunës.
2. Neni 62 paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:
Kryen zhvillimin e procedurave të prokurimit, procedurave të vlerësimit të ofertave dhe propozimeve për përzgjedhjen e operatorit ekonomik më të përshtatshëm, bazuar në kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 33

Drejtoria për Rini dhe Sport

1. Misioni i Drejtorisë për Rini dhe Sport është të përmirësojë dhe pasurojë jetën e komunitetit duke promovuar sportin, duke angazhuar të rinjtë në aktivitete sportive me synim që të bashkojë njerëzit përmes aktiviteteve sportive, iniciativave sportive dhe rinore.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Rini dhe Sport janë:
 - 2.1 Zhvillimi i politikave dhe strategjive për promovimin dhe zhvillimin e sportit dhe aktiviteteve rinore;
 - 2.2 Menaxhimi dhe mirëmbajtja e palestrave të sportit, sallave dhe fushave sportive;
 - 2.3 Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve rinore dhe sportive si dhe komunikimi i informacionit për ngjarjet për publikun;
 - 2.4 Zhvillimi dhe zbatimi i programeve dhe iniciativave për angazhimin e të rinjve në aktivitete rekreative, sigurimi i platformave për pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje si dhe mbështetja e klubeve dhe organizatave rinore;
 - 2.5 Administrimi i granteve dhe fondeve për të mbështetur iniciativat rinore dhe sportive si dhe vlerësimi dhe përzgjedhja e projekteve që përputhen me qëllimet e komunës;
3. Drejtoria për Rini dhe Sport udhëhiqet nga Drejtori dhe i raporton Kryetarit të Komunës.
4. Në kuadër të kësaj Drejtorie bëjnë pjesë :
 - 4.1.1 Sektori për Rini;
 - 4.1.2 Sektori për Sport.
5. Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Rini dhe Sport është tetë (8).

Neni 34

Sektori për Rini

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Rini janë:
 - 1.1 Zhvillimi dhe zbatimi i programeve dhe aktiviteteve që promovojnë aktivitetet rinore që përfshijnë të gjitha grup moshat dhe nivelet e aftësive të të rinjve;
 - 1.2 Krijimi i mundësive për angazhimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse brenda komunës, përfshirë themelimin e këshillave rinore ose grupeve këshillimore për çështjet që prekin të rinjtë;
 - 1.3 Promovimi dhe organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve rinore për të inkurajuar të rinjtë për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme rinore;
 - 1.4 Zhvillimi dhe zbatimi i iniciativave që adresojnë nevojat sociale dhe emocionale të të rinjve, duke përfshirë shërbimet e këshillimit, mbështetjen për të rinjtë në rrezik përmes programeve që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien mendore;
